

## VIRON KONA - PROFIL I NJË SHKRIMTARI

Shkrimtari Viron Kona ka kohë që i prezantohet lexuesit shqiptar dhe atij të huaj me librat e tij për fëmijë dhe të rritur, kryesisht në gjininë e romanit, novelës, poezisë dhe përmbledhjeve me tregime. Korpusi i veprës së tij arrin sot në 40 vëllime, një numër i të cilave janë vlerësuar me çmime kombëtare. Kurse vëllimi i tij “Eh, more Bubulino!”, është shpallur libri më i mirë për fëmijë i vitit 2006 nga UNICEFI. Dy vëllimet e para të këtij libri janë përkthyer në një libër të vetëm në Suedi.<sup>(1)</sup>

Shkrimtari Viron Kona ka disa veçori të dukshme në punën e tij krijuese e shumë prodhimtare. Ai shkruan duke e njohur mirë realitetin, gjeografinë dhe historinë e vendit ku zhvillon ngjarjet e romanit apo të tregimit. Për të shkruar librat “Dardi”, “Dardi në gadishullin e vetëtimave”, “Delfini i dy deteve drejt aventurave të reja”, “Pulëbardhat përbindëshe”, ai ka shkelur në shumë mjedise të gadishullit të Karaburunit, duke lundruar edhe vetë më parë me anije përqark këtij gadishulli. Gjirin e Vlorës e ka përshtuar disa herë me mjete detare, duke filluar me varkat dhe anijet e peshkimit, me katra silurues dhe anije të tjera luftarake. Ai është futur me anije edhe në shpellën e Haxhi Alisë në Karaburun, ndërkohë që, është nga civilët e rrallë, që ka lundruar deri edhe me nëndetëse. Ndërkaq, Viron Kona ka përshkruar në këmbë mjedise të ishullit të Sazanit, kepa dhe gjire të këtij ishulli ekzotik për çdo shqiptar, ka parë atje vende që zgjojnë kureshtje dhe admirim, e që njëherazi janë mjedise ku ai zhvillon ngjarjet, ku veprojnë personazhet e librave të tij. Kur shkroi librin “Të çuditshmit”, kushtuar historisë së kalasë së Kaninës si dhe librin

---

<sup>1</sup> Viron Kona, Men kara Bubulino! Tryckt hos “Bordin” Boras 2011. ISBN: 978-91-978 761-5-5. Erik Jullander “Modeli shqiptar”. Gazeta “Boras Tidning”, Suedi 19 maj 2011. (Sokol Demaku: “Në Boras të Suedisë doli nga shtypi libri për fëmijë dhe të rinj “Bubulino” i shkrimtarit Viron Kona. Revista “Dituria”, Boras, Suedi, 10 maj 2011.)

“Bubulinoja dhe Dardi në kryeqytetin e amantëve të lashtë”, ai shkoi në këto kala të vjetra, i vëzhgoi nga afër, lexoi shumë për historinë dhe arkeologjinë e tyre, si dhe bëri dhjetëra fotografi në mjediset ku do të zhvillonin episode dhe ngjarje personazhet e tij. Kur shkroi librat “Një udhëtim i çuditshëm” dhe “Të fshehtat e një mrekullie”, që në qendër kanë një fluturim me helikopter mbi Rrugën e Arbrit, shkuarjen në Lurë dhe ngjitjen në Korab, ai i shkeli vetë disa nga këto vende: shkoi në Gurë të Bardhë për të parë Petralbën, shtëpinë e Pjetër Budit dhe urën e famshme të Vashës; shkoi në Klos, Bulqizë, Lurë e Radomirë. Kështu ka vepruar edhe në Krujë, ku ka vizituar nga afër kalanë e Krujës dhe Albanopolin, Shkëmbin e Vajës, Qafështamën dhe Sari Salltëkun; ka shkuar në Lezhë për të parë Shëngjinin, por dhe Lisin dhe Akrolisin, në Shkodër për t’u ngjitur në kalanë e Rozafës, në Prespë për të shkuar me varkë në ishullin e Maligradit, në Himarë për të parë shpellën e ciklopit Polifem dhe kalanë e qytetit; në Palermo, në Butrint e Ksamil, në Apoloni, në Orikum e Llogara, në Palasë e Dhërmi për të parë “Rrugët e Bardha”, ku zbarkoi Cezari; në gjirin e Gramës, ku mendohet se ka qëndruar edhe Enea kur erdhi nga Troja dhe shkoi në Itali e ku, sipas Virgjilit, ndërtoi Trojën e re. Ka shkëlur në Gramoz, në Tomor dhe në kanionet e Osumit dhe Gradecit...Viron Kona të tregon si një skraparlli për Skraparin, si një kolonjar për Kolonjën, si një sarandjot për Sarandën dhe fshatrat e saj, për Konispolin dhe Çamërinë, për shqiptarët e Maqedonisë dhe veçanërisht për Gostivarin, për Kosovën dhe qytetet e saj Prizrenin, Gjakovën, Prishtinën, Mitrovicën ku ishte kohët e fundit...Ai të flet për Tiranën si një tiranas i vjetër, duke njohur thellë traditat, legjendat, historitë e qytetit, të kalave të Prezës, Petrelës.

Një veçori tjetër e këtij autori është se në çdo shtet të huaj ku ka shkuar, si në kohën e diktaturës, edhe në kohën e demokracisë, ai kur është kthyer ka shkruar doemos nga një libër. Viron Kona shkoi në Turqi në vitin 1982, si kryetar i ansamblit “Labëria”, dhe kur u kthye shkroi librin e njohur nga shumë lexues “Yje mbi Bosfor”. Kur u kthye nga Budapesti në vitin 1987, ku ai shkoi për të kryer një operacion të rëndë të pankreasit, ai shkroi librin “Dëgjoma zemrën, Budapest!” i cili është përkthyer së fundmi nga Thoma Dardeli dhe pritet botimi i tij në gjuhën hungareze. Me ardhjen

e demokracisë në Shqipëri, ai shkoi emigrant në Greqi dhe kur u kthye, shkroi romanin e tij të botuar mbi shtatë herë “Drithërimat e yjeve”, të cilin kritika e ka vlerësuar si një nga romanet më të mirë të shkruar për emigracionin. Ndërsa, Suedisë, këtij vendi të begatë nordik, ku ka qenë i ftuar disa herë për përrurimin e librave të tij apo në veprimtari të ndryshme kulturore dhe letrare, ai i ka kushtuar librat: “Bukuri suedeze”, “Për ju, miqtë e mi!”, “Zonja nga Borasi”, “Ju dua më shumë se veten!”, “Poleni Viking”, ky i fundit me bashkautor z. Sokol Demaku.

Për këtë autor, kritika, gazetarë e studiues, kanë shkruar dhjetëra artikuj studimorë, ndërkohë, që ai është ftuar vazhdimisht për të bashkëbiseduar rreth veprave të tij dhe letërsisë në universitete, shkolla të mesme dhe 9-vjeçare, si dhe në institucione të ndryshme kulturore. Deri tani ai ka regjistruar mbi 300 takime me lexues ku ka qenë i ftuar e ku janë zhvilluar bashkëbisedime rreth librave të tij. Në arkivin personal të këtij shkrimtari mund të gjesh mijëra pyetje të lexuesve, veçanërisht të vegjël, për librat e tij, por edhe shumë diskutime, përshëndetje e krijime që lexuesit e vegjël ia kushtojnë shkrimtarit dhe librave të tij për fëmijë. Ndërkaq, arkivin e tij e pasurojnë mijëra fotografi.

Dëshiroj t'i bëj me dije lexuesit se në një përmbledhje të botuar me rastin e 60 - vjetorit të lindjes së shkrimtarit, të titulluar “Blerimi i një fushe me krijime të bukura”, kanë shkruar për Viron Konën 65 autorë, me 85 artikuj, si dhe po aq diskutime krijuese nga lexues nxënës, gjimnazistë, studentë, pedagogë etj. 2) <sup>(2)</sup>Në një përmbledhje tjetër, që është duke u përgatitur për botim, janë përzgjedhur 84 artikuj të tjerë të shkruar nga 33 autorë. Gazetari i njohur Kadri Tarelli po përgatit një libër të veçantë kushtuar këtij autori, ku paraqiten një sërë artikujsh të shkruar nga studiues, gazetarë dhe shkrimtarë suedezë dhe nga bashkëkombësit tanë në Suedi. Gjithashtu, është duke u përgatitur një tjetër vepër përmbledhëse nga publicisti Bashkim Saliasi, me temë stilin dhe mjeshtërinë krijuese të librave për fëmijë të shkrimtarit Viron Kona, si dhe opinione dhe diskutime të dhjetëra lexuesve të

<sup>2</sup> Ibrahim Hajdarmataj, “Blerimi i një fushe me krijime të bukura”. Shtëpia botuese dhe shtypshkronja “West Print”, Tiranë 2010. ISBN: 978-99956-37-62-0. Xheladin Mjeku: “Vlerësime të përkushtuara për një penë të sukseseve”, “Zemra shqiptare”, Bukuresht 16.11.2011.

vegjël, që kanë shfaqur mendimet e tyre pas leximit të librave. Autorët që shkruajnë dhe vlerësojnë krijimtarinë e Viron Konës janë të ndryshëm: profesorë, studiues, shkrimtarë, kritikë arti, gazetarë, mësues. Midis tyre po përmend me respekt: Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaç, Prof. Dr. Shefik Osmani, Prof. dr. Koço Bihiku, Prof. Dr. Pajtim Bejtja, Prof. Dr. Hektor Veshi, Prof. As. Dr. Murat Gecaj, Prof. As. Dr. Qazim Dushku, Dr. Pandora Dedja, Dr. Bajram Mejdiaj; shkrimtarët dhe studiuesit: Ullmar Kvik (Qvick), Erik Jullander, Fatmir Terziu, Sokol Demaku, Hysen Ibrahim, Dalan Shaplo, Agim Cerga, Koço Kosta, Hyskë Borobojka, Gëzim Tushi, Ndoc Gjetja, Andon Andoni, Harallamb Fandi, Bashkim Kozeli, Ferdinand Hysi, Kadri Tarelli, Vjollca Spaho, Lule Shameti, Merita Thartori (Kuçi), Muharrem Dardha, Mehmet Deliu, Fatmir Minguli, Çelik Petriti, Zenel Sina, Ndue Dragusha, Sejdo Harka, Kristo Mërtiri, Fran Gjoka, Veledin Dyrmishi, Xheladin Mjeku, Nuri Dragoj etj.

Për të krijuar një ide më të drejtpërdrejtë për vlerat e shkrimtarit. Kona në letërsi, po citoj disa nga vlerësimet: Gjovalin Shkurtaç<sup>3</sup> në artikullin “Rreth gjuhës dhe ligjërimit artistik të librave të Viron Konës”, shkruan:

*“Kam kënaqësinë të them se, si gjuhëtar, duke lexuar librat e V. Konës, sidomos ato që u drejtohen fëmijëve dhe të rinjve, shquan kudo kujdesi dhe maturia në përzgjedhjen e fjalëve, shprehjeve dhe ndërtimeve sintaksore ashtu siç u vlen atyre, siç u duhet të rinjve. Pra ai gjakon të shkruajë bukur, me fjalë të thjeshta, me sintaksë tipike shqiptare, pa ngarkesa e kërkime të stërholluara, të cilat do t’ia tëhuajësonin librin lexuesit. Ai shkruan ashtu siç flasin dhe si duhet të flasin sot shkollarët tanë...”*

Pajtim Bejtja, në artikullin e tij kushtuar romanit “Drithërimat e yjeve”, ndër të tjera shkruan:

*“Ndjenja nga më të ndryshmet ma përshkonin e ma turbullonin shpirtin, tek përparoja në lexim. Keqardhje e protestë për vuajtjet e protagonistit-Viron dhe për fatin*

<sup>3</sup> Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaç: “Pesha e fjalës shqipe” (Studime të zgjedhura për gjuhën e letërsisë artistike). F. 278 – 282. Shtëpia Botuese “UFO Press”, Tiranë, tetor 2009.

e keq të emigrantit, në përgjithësi, zemërim dhe urrejtje për pronarët e pamëshirshëm dhe për policët shpirtkazmë, mirënjohje për njerëzit e mirë dhe humanë grekë ...Kur mbarova romanin, i mbushur plot me emocione të këndshme nga mbresat që më kishte lënë, guxova të bëj kritikun, pa qenë i fushës së letërsisë, dhe të deklaroj: “Ky është libri më i mirë që ka shkruar Vironi deri tani! S’do ta shkruante dot, pa pasur përjetime personale!”. Dhe, papritmas, filloi të mos më vijë keq për vuajtjet e pamërituara të tij dhe të mos i gjykoj aq rreptë pronarët dhe policët grekë... E vlejnë tre muaj vuajtje, kur arrijnë të frymëzojnë për të shkruar një kryevepër...”!

Historiani i letërsisë, Koço Bihiku,<sup>(4)</sup> pasi merr në analizë librin për fëmijë të Viron Konës, të titulluar “Kontrolli i befasishëm i një inspektori”, në përfundim shkruan:

*“Libri i Viron Konës “Kontrolli i befasishëm i një inspektori”, ka rëndësi, jo vetëm për vlerën e veçantë edukative, por edhe për format artistike, për rrëfimin e natyrshëm e të thjeshtë dhe të rrjedhshëm që e shquan. Këto merita, i tërheqin të rinjtë, të cilëve u adresohet ky libër”.*

Hektor Veshi,<sup>(5)</sup> në një artikull të tij, ndër të tjera vlerëson se Viron Kona është:

*“Një “galeri” dashurie njerëzore dhe krijimtari, të pasur e të vyer... kush s’e njeh, dëshiron me zjarr ta njohë; kurse ndonjëri, si unë që e njoh nga afër, vihet në vështirësi të mëdha për të gjetur fjalët dhe shprehjet e denja për dashurinë ndaj të tjerëve, që rrezaton ky njeri, figura e tij, mësues e drejtues shkollë, punonjës i aparateve shtetërore a gazetar. Admirimi për të rritet, kur nëpër libra lexuesi njihet me “bagazhin” e dijeve të shumta, në të gjitha format artistike, që gjen ose zbaton për t’ua transmetuar idetë lexuesve të çdo niveli shkollimi, sidomos fëmijëve...”.*

Albanologu, shkrimtari, poeti dhe përkthyesi suedez Ullmar Kvik, (Qvick)<sup>(6)</sup> i cilësuar nga shoqatat shqiptare të Suedisë “Mik

<sup>4</sup> Prof. Dr. Koço Bihiku: “Bregat e mërgimit”. Gazeta “Temp”, 29 maj 2005.

<sup>5</sup> Hektor Veshi: Gazeta “Mësuesi”, “Tre mësues, krijues zemërmëdhenj”. Tiranë, 04 maj 2011.

<sup>6</sup> Ullmar Qvick(Kvik): “Kush është i ri në shpirt dhe në zemër mbetet gjithmonë

i madh i shqiptarëve”, kur komenton ngrohtësisht librin e Viron Konës “Për ju miqtë e mi!”, midis të tjerash shkruan:

*“Kush është i ri në shpirt dhe zemër mbetet gjithmonë i ri. Përshkrimi i ambienteve... takimeve...ngjarjeve gjatë vizitës së Vironit në vitin 2011 ka të bëjë sidomos me shkollat, bibliotekat dhe me jetën shpirtërore të fëmijëve, domethënë për ato fusha të jetës që janë më afër zemrës së një pedagogu dhe një autori të librave për fëmijë. Po presim që të vazhdojë kjo miqësi frytdhënëse dhe shpresëdhënëse që përhap Viron Kona përmes vizitave dhe në tërë veprimtarinë e tij. Ai është bërë ambasadori ynë i kulturës suedeze në Shqipëri. Sigurisht vetëm “honoris causa”, sepse siç dihet, mundimet kulturore shpërblehen shumë keq në këtë botë... Ne jemi të lumtur dhe të nderuar të kemi në mesin tonë miq besnikë shqiptarë si Viron Kona me shokë, të cilët pa u lodhur ndërtojnë urë mirëkuptimi midis popujve tanë. Mirë u pafshim në Suedi dhe në Shqipëri, miku ynë i shtrenjtë Viron Kona”!*

Kurse, në një mesazh, që Sokol Demaku poet, shkrimtar, përkthyes dhe gazetar në Boras të Suedisë, i drejtoi albanologut, poetit dhe përkthyesit suedez Ullmar Kvik, ku e vinte në dijeni të veprimtarisë së tij dhe të disa shkrimtarëve të tjerë suedeze për përhapjen e kulturës dhe letërsisë suedeze në trojet shqiptare të Maqedonisë, Ullmar i kthen këtë përgjigje:

*“Din vilja och energi är beundransvärd, bäste Sokol. Det som albanska intellektuella och ärliga politiker skulle behöva är böcker om de svenska folkrörelserna och demokratins utveckling under 150 år. Det behövs oberoende folkrörelser i alla albanska områden. Viron Kona skulle kunna göra en sådan bok, om han bara kunde svenska språket”,*

që në gjuhën shqipe përkthehet:

*“Vullneti dhe energjia juaj janë të admirueshme, i dashur Sokol. Ajo që politikanët dhe intelektualët e ndershëm shqiptarë do të kishin nevojë, janë librat për lëvizjet popullore suedeze dhe zhvillimin e demokracisë për 150 vjet. Lëvizjet*

*popullore të pavarura janë të nevojshme në të gjitha trojet shqiptare. Viron Kona mund të bënte një libër të tillë nëse ai do ta njihnte gjuhën suedeze”.*

Hysen Ibrahimimi,<sup>(7)</sup> kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë të Suedisë, si dhe zëvendëskryetar i Lidhjes së Krijuesve Shqiptarë për Mërgatën, në referatin e tij përurues të librit të Viron Konës “Zonja nga Boras”, mbajtur në Boras (Borås) të Suedisë më 30 mars 2013, ndër të tjera shkruan:

*“...Gjatë leximit të këtij libri, hasim formën e bukur të përpunimit të ngjarjeve, temave, hasim në përshkrimin e përjetimeve të autorit në Suedi, më konkretisht në Boras, ku dominon përvoja e shkëlqyer e këtij shkrimtari. Me një mjeshhtëri të rrallë, ai ka përshkruar përjetime të këndshme, duke prekur disa sfera, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me shpirtin e njeriut...Në librin “Zonja nga Borasi”, Viron Kona, nuk mbetet thjesht vetëm shkrimtar në këtë rast, por del edhe si studiues i mirëfilltë, duke ilustruar dhe zbuluar në mënyrë faktike me të drejtë ngjashmëri të kulturave dhe traditave suedeze me kulturën dhe traditën shqiptare. E përgëzojmë nga zemra, shkrimtarin, studiuesin, mikun tonë të madh, vëllain tonë të dashur Viron Kona, për këtë libër me vlera të larta, të cilin po e promovojmë sot këtu, duke shpresuar se ai nuk do të ndalet me kaq, por në të ardhmen do të na dhurojë edhe vepra të tjera me brumë e tematika të ngjashme, për çka komuniteti shqiptar që jeton e vepron në Suedi me miqtë suedeze gjithnjë ka nevojë dhe për çka ne e falënderojmë me admirim. Urime dhe përgëzime”!*

Sokol Demaku,<sup>(8)</sup> poet, prozator, përkthyes, drejtuesi i revistës “Dituria”, në Suedi, shkruan:

*“Rrallëherë kam pasur fatin të njoh një temperament të këtyllë të pasionuar pas ngjarjeve interesante dhe me vlerë për letërsinë, duke shkruar tregimet e tij aq mjeshhtërisht dhe*

<sup>7</sup> Hysen Ibrahimimi: “Përurohet në Suedi libri i shkrimtarit shqiptar Viron Kona “Zonja nga Borasi”, Revista “Dituria”, Suedi, 30 mars 2013.

<sup>8</sup> Sokol Demaku: “Viron Kona dhe Zonja nga Borasi”, Botuar në VOAL (“Zëri i shqiptarëve” më 08.09.2013).

*me një kreativitet që lexuesit i japin kënaqësi në lexim. Ai, sa unë shoh këtu, frymon duke jetuar përmes shkrimeve, përmes përshkrimit të ngjarjeve, përmes njerëzores, duke kërkuar të deshifrojë përmbajtjen e brendisë së vlerave, motiveve dhe ideve, por sidomos ato rrugë që shpien nga konkluzionet e ekzistencës së disa rrënjëve të përbashkëta njerëzore pa marrë parasysh se në cilën hemisferë të tokës njeriu jeton dhe frymon. Dua ta them edhe këtë se në ditët e sotme nuk është e lehtë të gjesh një të tillë, që të ketë shëtitur kaq shumë, gjithmonë i qetë, i ngadalshëm, me shumë krenari në punën e tij dhe të sjellë në truallin e tij aq shumë mendime dhe ide njerëzore qëllimmira, të cilat do të gjejnë vend dhe shprehje besoj te gjeneratat e reja”.*

Qibrje Hoxha, qytetare shqiptaro-suedeze, me banim në Stokholm, atdhetare, deputete e kuvendit të parë të Kosovës, përkthyesë në gjuhën suedeze e librit “Bubulino” të Viron Konës, ndër të tjera shkruan:

*“Libri “Eh more Bubulino!” përcjell mesazhe të bukura dhe pozitive pikërisht për vlerat e mira të kombit tonë, si dhe të bukurive të cilat ia ka falë Zoti, Shqipërisë sonë të mrekullueshme. Butësia dhe urtësia e shpirtit të z. Viron, bën për vete secilin vogëlush, i cili njihet me Bubulinon, dhe kjo tani po ndodh edhe me lexuesit e vegjël suedeze. Jam e nderuar që m’u dha rasti të bëj një angazhim modest për përkthimin e këtij libri. Për mua dhe familjen time, përkthimi i “Bubulinos” ka qenë kënaqësi e papërshkrueshme, por edhe një detyrë ndaj Shqipërisë. Juve z. Viron, jeni një shkrimtar, i cili përmes shpirtit të butë, zemrës së madhe dhe penës së mprehtë, dërgoni mesazhet më të bukura njerëzore për mirësinë, të vërtetën. Kurse ndaj shtetit tim amë, kam detyrim të përjetshëm, që të afirmoj vlerat më të bukura të kombit tim”.*

Dr. Fatmir Terziu,<sup>9</sup> shkrimtar, poet, studiues, kineast dhe drejtues i faqes elektronike “Fjala e lirë”, Londër, në artikujt kushtuar këtij shkrimtari, mes të tjerash shkruan:

<sup>9</sup> Fatmir Terziu (Londër): “Gotikja e prozës së Viron Konës”.Revista “Fjala e lirë”, Londër 11.12.2010.



*“Shkrimtari shqiptar, Viron Kona, një nga më prodhimtarët e më cilësorët e viteve të fundit, natyrisht mund të lexohet edhe si një tekst mes terminologjisë moderne. I tillë është ai në jo pak raste. E tillë është krijimtaria e tij e bollshme dhe mjaft e lexueshme për të gjitha moshat. Ndërsa kapërcen shifrën e mbi tridhjetë botimeve, ai tashmë është një emër sa vendor dhe global. Vjen me vlerësimet vendore, por edhe me ato nga përtej vendit, nga Suedia. Dhe, atje, ai natyrshëm mirëkuptohet në dygjuhësi”.*

Në parathënien e romanit “Drithërimat e yjeve”, sociologu i njohur shqiptar Gëzim Tushi,<sup>(10)</sup> ndër të tjera shkruan:

*“Viron Kona është një autor që kërkon më shumë vëmendje të kritikës profesioniste. Tani lexuesi ka në duar një sasi të gjerë të prodhimit të bollshëm artistik të tij. Por padyshim ky roman (“Drithërimat e yjeve”) përbën një nga majat e krijimtarisë së autorit, përbën veprën më të mirë në të cilën janë të konsoliduara vlerat artistike dhe estetike, stili dhe mjeshtëria e tij krijuese. Lexuesi i vëmendshëm i veprës së Konës, do të dallojë, edhe kur lexon librat e tij të shumtë për fëmijë, tregimet, novelat apo romanin në fjalë, një stil të veçantë, të ngrohtë dhe të singertë. I tillë është autori”.*

Studiuesi Sejdo Harka,<sup>(11)</sup> ish – kryeredaktor i gazetës “Mësuesi” në një artikull të shkruar në librin e tij “Modernët e kohës” shprehet kështu për Vironin:

*“Kush e njohu nga afër shkrimtarin Viron Kona dhe nuk u mrekullua nga fjala e ngrohtë dhe buzëqeshja e singertë, nuk u befusua nga kultura e gjerë dhe shembulli i njeriut të drejtë, nuk u impresionua nga hapat e tij të matura dhe vendosmëria për të çarë në jetë, nuk u frymëzua nga përkushtimi për punën dhe durimi për të thyer çdo vështirësi e pengesë. Kur shfleton*

<sup>10</sup> Gëzim Tushi: “Tema sociale e emigracionit” dhe “Viron Kona dhe letërsia për fëmijë”. Viron Kona, “Drithërimat e yjeve”, Shtëpia botuese West Print 2011. ISBN:978-99956-37-7-2-9. Gazeta “Drita” 10 tetor 2004, Gazeta “Shkëndija” Prishtinë, nëntor 2007.

<sup>11</sup> Sejdo Harka: “Syqelqi mban të mbërthyer Prometheun”. Gazeta “Tirana Observer” dhjetor 2009.

*krijimtarinë e tij të gjerë dhe tepër të larmishme, prek me sytë e mendjes dhe të shpirtit realitete dhe fantazi që projektojnë ëndrrat e njerëzve të sotshëm dhe të ardhshëm. Me vizionin e tij artistik, zhbiron shpirtra njerëzorë, ndërton dhe rindërton karaktere sa reale, aq edhe të çuditshëm, zbulon e afirmon vlera dhe fshikullon vese e antivolera. Përmes magjisë së fjalës përjeton ëndrra zhvillimi dhe vret frikën e zhgënjimin, mbjell embrione lirie dhe rindërton ura miqësie... Viron Kona, është jo vetëm një veprimtar dhe krijues i papërsëritshëm, por edhe një bashkëshort, baba e gjysh shembullor. Portretin e tij e zbukurojnë sinqeriteti dhe thjeshtësia, mirëkuptimi dhe butësia, kthjelltësia e mendimit dhe gjakftohtësia, miqësia e pastër dhe besnikëria. Temperamenti i tij i qetë, bën që ai të flasë edhe kur hesht. Përmes fjalës së matur dhe buzëqeshjes së tij të sinqertë, ai përçon te shokët dhe miqtë e tij mesazhe të ngrohta solidariteti dhe miqësie, respekti dhe dashurie. Është kjo arsyeja që Viron Kona, ka shumë miq e shokë, jo vetëm brenda, por edhe tej kufijve të vendit”.*

Në përfundim të këtij artikulli, vlerësojmë se që nga viti 2004 Viron Kona ka kontribuar në letërsi dhe publicistikë si anëtar i Këshillit Kombëtar të Librit dhe si kryeredaktor i revistës “Siguria rrugore”. Por ai ka qenë mjaft aktiv edhe në Shoqatën e Arsimitarëve të Shqipërisë, duke dhënë ndihmesë të çmuar në mjaft veprimtari të organizuara nga kjo shoqatë, dhe veçanërisht duke mbajtur tema interesante në veprimtaritë tradicionale që shoqata ka organizuar me rastin e 7 Marsit, Festës së Mësuesit. Fjala e tij është pritur vazhdimisht me kureshtje dhe interesim, pasi ai ka shprehur aty idetë, ndjenjat dhe përvojën e një shkrimtari të njohur dhe mjaft të dashur për fëmijët, por edhe të një mësuesi dhe drejtuesi shkollash me përvojë dhe të kualifikuar. Ndërkaq, Shoqata e Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë të Suedisë, ka kohë që e ka shpallur këtë shkrimtar *Anëtar Nderi* të saj.

Historia na mëson se njerëzit e penës, kanë qenë gjithnjë të vlerësuar, si për kontributet e tyre krijuese, ashtu dhe për jetën personale e sociale. Aata janë edhe një vlerë për vendin dhe shoqërinë e kohës kur jetojnë, por dhe për kohët që vijnë më pas.

Njerëzit e çdo kohe, kanë nevojë gjithnjë të mësojnë biografinë e atdheut dhe të kombit të tyre, dhe kjo mendoj se bëhet duke i

bërë të njohura vlerat e krijuesve dhe të personaliteteve të kohës, që me punën dhe veprën e tyre, kanë zënë vend të merituar në historinë e një kombi. Ata, pa u thënë dhe pa i detyruar askush, sakrifikojnë dhe përkushtohen plotësisht në dobi të progresit. Mendoj se, ndër mijëra prej tyre, është dhe protagonist i cilit po i kushtoj këtë punim, shkrimtari shqiptar Viron Kona. E gjithë jeta dhe vepra e tij, pa asnjë rezervë, është udhëhequr nga lajtmotivi për t'i shërbyer me shpirt e zemër atdheut dhe kombit.

### *Bibliografia:*

- Viron Kona, Men kara Bubulino! Tryckt hos "Bordin" Boras 2011. ISBN: 978-91-978 761-5-5.
- Erik Jullander "Modeli shqiptar". Gazeta "Boras Tidning", Suedi 19 maj 2011.
- Sokol Demaku: "Në Boras të Suedisë doli nga shtypi libri për fëmijë dhe të rinj "Bubulino" i shkrimtarit Viron Kona. Revista "Dituria", Boras, Suedi, 10 maj 2011.
- Ibrahim Hajdarmataj, "Blerimi i një fushe me krijime të bukura". Shtëpia botuese dhe shtypshkronja "West Print", Tiranë 2010. ISBN: 978-99956-37-62-0. Xheladin Mjeku: "Vlerësime të përkushtuara për një penë të sukseseve", "Zemra shqiptare", Bukuresht 16.11.2011.
- Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj: "Pesha e fjalës shqipe" (Studime të zgjedhura për gjuhën e letërsisë artistike). F. 278 - 282. Shtëpia Botuese "UFO Press", Tiranë, tetor 2009.
- Prof. Dr. Koço Bihiku: "Bregat e mërgimit". Gazeta "Temp", 29 maj 2005.
- Hektor Veshi: Gazeta "Mësuesi", "Tre mësues, krijues zemërmëdhenj". Tiranë, 04 maj 2011.
- Ullmar Qvick (Kvik): "Kush është i ri në shpirt dhe në zemër mbetet gjithmonë i ri", Gazeta "Mësuesi", Tiranë 11 maj 2012.
- Hysen Ibrahim: "Përrurohet në Suedi libri i shkrimtarit shqiptar Viron Kona "Zonja nga Borasi", Revista "Dituria", Suedi, 30 mars 2013.

- Sokol Demaku: "Viron Kona dhe Zonja nga Borasi", Botuar në VOAL ("Zëri i shqiptarëve" më 08.09.2013).
- Fatmir Terziu (Londër): "Gotikja e prozës së Viron Konës". Revista "Fjala e lirë", Londër 11.12.2010.
- Gëzim Tushi: "Tema sociale e emigracionit" dhe "Viron Kona dhe letërsia për fëmijë". Viron Kona, "Drithërimat e yjeve", Shtëpia botuese West Print 2011. ISBN:978-99956-37-7-2-9. Gazeta "Drita" 10 tetor 2004, Gazeta "Shkëndija" Prishtinë, nëntor 2007.
- Sejdo Harka: "Syqelqi mban të mbërthyer Prometheun". Gazeta "Tirana Observer" dhjetor 2009.